



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt,
Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake
Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 5 gusht 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit të Bashkim Smakajt

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiq

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit:
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhjetor 2024, Hashim Thaçi ("z. Thaçi" ose "i akuzuari"), i paraburgosur tashmë në kontekst të procesit gjyqësor Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve ("Çështja 06"), në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS"), iu dorëzua fletarrestimi, i lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në procesin aktual², *proprio motu* dhe pas konfirmimit të aktakuzës kundër tij, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit ("Vendimi i Konfirmimit").³
2. Më 8 dhjetor 2024,⁴ 7 shkurt 2025,⁵ dhe 7 prill 2025,⁶ Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi.

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Çështje Përkatëse* ("Vendimi për Arrestimin"), 29 nëntor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; shih Shtojcën 4 ku përfshihet fletarrestimi për z. Thaçi. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor u lëshua më 19 dhjetor 2024, [F00037/RED](#).

³ KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#).

⁴ KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës, *Paraqitja e Parë e Hashim Thaçit* ("Vendimi për Paraburgimin"), 8 dhjetor 2024, publik, f. 18, rreshtat 10-20.

⁵ KSC-BC-2023-12, F00165, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Review of Detention of Hashim Thaçi](#) (Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit) ("Vendimi i Parë i Rishikimit"), 7 shkurt 2025, publik.

⁶ KSC-BC-2023-12, F00250, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Second Decision on Review of Detention of Hashim Thaçi](#) (Vendimi i Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit)(Vendimi i Dytë i Rishikimit"), 7 prill 2025, publik.

3. Më 14 prill 2025, pas vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit,⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi më tej për z. Thaçi formën e përgjegjësisë penale për pengimin e personave zyrtarë sipas Pikave 1, 2 dhe 3 të Aktakuzës së Konfirmuar të 5 dhjetorit 2024, në bazë të nenit 32(3) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Ligjit nr. 06/L-074, ("Vendimi i Ndryshimit").⁸ Më 16 prill 2025, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ("Aktakuza e Konfirmuar e Ndryshuar").⁹

4. Më 5 maj 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi ("Vendimi i Tretë i Rishikimit").¹⁰

5. Më 7 korrik 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrime mbi rishikimin e rregullt të paraburgimit të z. Thaçi ("Parashtrimet e ZPS-së").¹¹

6. Mbrojtja e z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçi") nuk u përgjigj ndaj parashtrimeve të ZPS-së.

⁷ KSC-BC-2023-12, IA002/F00012, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 3 prill 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, [IA002/F00012/RED](#).

⁸ F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Amending the "Decision on the Confirmation of the Indictment" and Setting a Date for the Submission of Preliminary Motions](#) (Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmim e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake), 14 prill 2025, publik.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00264, Prokurorja e Specializuar, [Submission of Amended Confirmed Indictment](#) (Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), 16 prill 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale (që përfshin versionin konfidencial të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), dhe [Annex 2](#) (Shtojca 2), publike (që përfshin versionin e redaktuar publik të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar).

¹⁰ KSC-BC-2023-12, F00325, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Third Decision on Review of Detention of Hashim Thaçi](#), (Vendimi i Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit), 5 qershor 2025, publik.

¹¹ KSC-BC-2023-12, F00363, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 7 korrik 2025, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 10 korrik 2025, F00363/RED.

II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja kërkon që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të vazhdojë paraburgimin e z. Thaçi, sepse nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rrethanave që do të kërkonte (si pasojë) nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake të devijonte nga konstatimet e saj në Vendimin e Tretë të Rishikimit.¹²

8. Më konkretisht, ZPS-ja pretendon se paraburgimi i z. Thaçi vazhdon të jetë i domosdoshëm pasi vazhdojnë të jenë të qartë të tre rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit dhe asnjë kusht për lirim apo garanci të ofruara nga z. Thaçi nuk mund të ulë mjaftueshëm këto rreziqe.¹³ Sipas ZPS-së, rreziqet në fjalë mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së.¹⁴

9. Së fundi, ZPS-ja parashtron se koha e shkurtër që ka kaluar nuk ndryshon vlerësimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në Vendimin e Tretë të Rishikimit se paraburgimi i z. Thaçi vazhdon të jetë i arsyeshëm dhe proporcional sepse: (i) ndaj z. Thaçi janë ngritur njëmbëdhjetë (11) akuza për vepra penale sipas nenit 15(2) dhe, në qoftë se shpallet fajtor mund të marrë një dënim të gjatë; dhe (iii) procesi po vijon me ritëm të shpejtë.¹⁵ Në lidhje me këtë, ZPS-ja thekson se, që nga Vendimi i Tretë i Rishikimit: (i) Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka lëshuar vendime në lidhje me të gjitha mocionet paraprake; (iii) hapa të rëndësishëm hetimorë vazhdojnë të nisen dhe të përfundohen; (iii) rezultatet e kontrollimit të telefonave të sekuestruar i janë dhënë dhe vazhdojnë t'i jepen të akuzuarit mënyrë të rregullt; (iv) ZPS-ja ka dorëzuar njoftimin e saj të tretë sipas rregullës 102(3) të Rregullores dhe ka vazhduar të nxjerrë materialin e kërkuar për Mbrojtjen e të gjithë të akuzuarve; dhe (v) vijon nxjerrja e materialit tjetër që kërkohet nga Rregullorja.¹⁶

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 3, 4, 7, 9.

¹³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

¹⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

¹⁶ Përgjigja e ZPS-së, para. 6.

ZPS-ja shton gjithashtu se, me procesin për nxjerrjen e materialit, z. Thaçi po njihet gjithnjë e më shumë me provat kundër tij.¹⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Sipas nenit 41(6) të Ligjit, DHS-ja urdhëron arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur: (a) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer një vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së; dhe (b) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një veprë penale, ose do të pengojë ecurinë e procesit penal përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryerësit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

11. Sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, deri në momentin kur aktgjykimi merr formë të prerë ose deri në lirin nga paraburgimi, pas dy (2) muajsh nga vendimi i fundit për paraburgimin, paneli i ngarkuar me çështjen, shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

12. Në pajtim me nenin 41(12) të Ligjit, krahas masës së paraburgimit, për të siguruar praninë e të akuzuarit, përfshirë nëpërmjet videokonferencës, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, ose për të siguruar kryerjen e suksesshme të procedurës penale, nga DHS-ja mund të urdhërohen masat në vijim: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në ndonjë vend tjetër dhe masa alternative shmangëse.

13. Sipas rregullës 56(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para

¹⁷ Përgjigja e ZPS-së, para. 6.

fillimit të çështjes dhe, në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, pasi ka dëgjuar palët, paneli mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI I ZBATUESHËM

14. Standardi që rregullon paraburgimin është trajtuar gjerësisht në vendime të mëparshme kështu që është përfshirë këtu përmes referencave.¹⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të zbatojë këtë standard edhe në këtë vendim.

B. DYSHIMI I BAZUAR

15. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin e Konfirmimit u konstatua se, në bazë të nenit 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Thaçi është penalisht përgjegjës për vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, konkretisht shkelje e fshehtësisë së procesit, mosbindje ndaj gjykatës dhe pengim i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe brenda kuptimit të neneve 392, 392 , dhe 401 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074, përkatësisht, në shkelje të nenit 15(2) të Ligjit.¹⁹ Këto konstatime u bënë mbi bazën e një standardi më të lartë se ai i dyshimit të bazuar që kërkohet sipas të nenit 41(6)(a) të Ligjit.²⁰ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se në këtë çështje gjyqësore nuk ka pasur zhvillime që do t'i ndryshonin këto konstatime.

¹⁸ Shih [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 14-15 (kriteret e përgjithshme), 16 (dyshimi i bazuar), 19-22 (domosdoshmëria e paraburgimit), 36 (lirimi me kusht), 40 (proporcionaliteti), dhe referencat që citohen në të; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 12-13 (kriteret e përgjithshme), 14 (dyshimi i bazuar), 17-20 (domosdoshmëria e paraburgimit), 37 (lirimi me kusht), 41 (proporcionaliteti), dhe referencat që citohen në të;

¹⁹ [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 313(a). Shih gjithashtu më lart, para. 3.

²⁰ Shih [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 42-43; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 43. Shih ngjashëm, KSC-BC-2020-04, F00075/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shala](#) (Version i Redaktuar Publik Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), 10 shtator 2021, publik, para. 22; dhe F00224/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of](#)

16. Rrjedhimisht, në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Thaçi ka kryer vepra penale brenda juridiksionit të DHS-së, të përcaktuara në nenin 41(6)(a) të Ligjit.²¹

C. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

1. Rreziku i arratisjes

17. Sa i takon rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se janë ende relevante të gjitha aspektet që janë përcaktuar në Vendimin e Tretë të Rishikimit, përkatësisht: (i) pesha e veprave penale për të cilat akuzohet z. Thaçi në procesin aktual dhe mundësia e një dënimi të gjatë në rast të shpalljes së fajësisë; (ii) synimet *mala fide* të z. Thaçi ndaj ligjeve dhe rregullave të DHS-së; dhe (iii) mjetet dhe mundësia e tij për t'u arratisur, përkundër paraburgimit të tij në procesin e Çështjes 06.²² Krahës kësaj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake i kushton rëndësi faktit që z. Thaçi vazhdon të njihet me provat që mbështesin akuzat kundër tij si rezultat i procesit të nxjerrjes në vijimësi të materialit.²³

18. Bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që tregon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se në këtë moment vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të arratiset.

[Detention of Pjetër Shala](#), (Version i Redaktuar Publik Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), 22 qershor 2022, publik, para. 24.

²¹ *Shih* [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 18; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 17; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 7; Vendimi për Paraburgimin, f. 15, rreshtat 1-7.

²² [Thrid Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 19. [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 23. *Shih gjithashtu* Vendimin për Paraburgimin, f.18, rreshtat 16-24, [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 47-48.

²³ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se që, nga Vendimi i Tretë i Rishikimit, ZPS-ja ka nxjerrë material shtesë sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores. *Shih, për shembull* Paketat 50, 54 dhe 55 të materialit të nxjerrë.

2. Rreziku i pengimit të ecursë së proceseve të DHS-së

19. Sa i përket rrezikut të pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdojnë të vlejné aspektet e shqyrtuara në Vendimin e Tretë për Rishikimin, konkretisht: (i) se z. Thaçi bashkërendoi me tri grupe të ndryshme, i të cilave ai ishte udhëheqës, për të ndërhyrë ndaj dëshmitëve të dëshmitarëve të ZPS-së në gjykimin aktual në Çështjen 06, përfshirë duke zbuluar dhe dhënë qëllimisht informacionin konfidencial në lidhje me dëshmitarë, dhe duke udhëzuar të tjerët që të ushtronin ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitëve të dëshmitarëve dhe si ta bënin këtë; (ii) se veprimet dhe sjellja e z. Thaçi janë pjesë e një praktike më të gjerë përpjekjesh për ndërhyrje në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së në Çështjen 06; (iii) se veprimet e z. Thaçi tregojné këmbënguljen për të vijuar përpjekjet për pengim të procesit të DHS-së edhe nga brenda objektit të paraburgimit të DHS-së, përfshirë duke ushtruar ndikim mbi ish-anëtarë të UÇK-së që janë besnikë ndaj tij, dhe mbi njerëz nga qarqet politike të tij, si p.sh, të akuzuarit e tjerë në këtë proces; (iv) se konstatimet e mëparshme sugjerojnë se z. Thaçi tentoi të dëmtonte DHS-në, dhe, përmes qarqeve të tij, u ofroi shpërblime personave të cilët u thirrën nga ZPS-ja që t'i jepnin informacion ZPS-së/DHS-së; (v) se z. Thaçi është në dijeni të akuzave dhe provave kundër tij; dhe (vi) se dijenia në rritje për provat inkriminuese kundër tij shërben si motiv që të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve ose të pengojë ecurinë e procesit aktual.²⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se: (i) se rreziku i pengimit të procesit nuk pushon së ekzistuari me përfundimin e paraqitjes së provave në Çështjen 06, sepse procesi vazhdon²⁵ dhe mund të ketë veprime hakmarrjeje ndaj

²⁴ [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 28), para. 21-22; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 28; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 30; Vendimi për Paraburgimin, f. 12, rreshti 15; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 50.

²⁵ [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 22, me referencat e cituara aty. *Shih gjithashtu* KSC-2020-06, F03371, Trupi Gjykses II, [Further Order on the Scheduling of the Defence Case and Related Matters](#) (Urdhër i Mëtejshëm për Planifikimin e Paraqitjes së Provave prej Mbrojtjes dhe Çështje Përkatëse), 25 korrik 2025, publik, para. 42.

dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi tashmë ose t'i nxisin ata që të tërheqin dëshmitë e tyre; (ii) rreziku i pengimit të procesit nuk vlerësohet vetëm në lidhje me procesin në Çështjen 06, por edhe për këtë çështje gjyqësore;²⁶ dhe (iii) procesi në vijimësi i nxjerrjes së provave rrit këtë rrezik më tej, sepse i jep qasje z. Thaçi në informacion të ndjeshëm në lidhje me dëshmitarë.²⁷

20. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson aspektet dhe faktorët e mësipërm në kontekstin e atmosferës së përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve aktualë dhe të mundshëm të DHS-së.²⁸ Në këtë kontekst, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson që rreziku që z. Thaçi të ushtrojë presion mbi dëshmitarët është veçanërisht i lartë,²⁹ duke pasur parasysh lidhjet e tij që përmenden më lart.³⁰

21. Bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të pengojë ecurinë e proceseve të DHS-së.

3. Rreziku i kryerjes së veprave penale të tjera

22. Sa i takon rrezikut të kryerjes së veprave penale të tjera sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera, në këto rrethana, faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i

²⁶ [Thrid Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 22.

²⁷ [Thrid Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 22; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 29, dhe referencat që citohen në të.

²⁸ [Thrid Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 23; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 31; Vendimi për Paraburgimin, f. 18, rreshtat 16-20; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 51.

²⁹ *Shih* [Thrid Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 23; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30 dhe referencat që citohen në të; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 31.

³⁰ *Shih më lart*, para. 19.

parë janë relevante edhe për vlerësimin e këtij të dytit.³¹ Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se, sa i takon rrezikut të pengimit të procesit, faktorët relevantë që duhet të merren parasysh janë të njëjtë me ata të përshkruar në paragrafët e mësipërm 19-20. Pasi ka shqyrtuar nga fillimi këta faktorë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdon të jetë e bindur se ekziston ende rreziku që z. Thaçi të përsërisë veprat penale që pretendohet se ka kryer, përfshirë në lidhje me dëshmitarë të cilët kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në Çështjen 06 dhe/ose në çështjen aktuale.³²

23. Bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se ende vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi të kryejë vepra penale të tjera.

4. Përfundim

24. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se, aktualisht, ka arsye të artikulueshme për të besuar se z. Thaçi mund të arratiset, të pengojë ecurinë e proceseve të DHS-së, dhe të kryejë vepra penale të tjera, çka e bën të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të vlerësojë në vijim nëse kushtet për lirimin e z. Thaçi mund të zvogëlojnë mjaftueshëm këto rreziqe.

D. LIRIMI ME KUSHT

25. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdon të jetë e mendimit se asnjë kusht nuk do të mund të ulë rreziqet ekzistuese në këtë fazë, veçanërisht rrezikun që i

³¹[Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 25; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 33; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 33; Vendimi për Paraburgimin, f. 15, rreshti 3-7; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 53.

³² *Shih gjithashtu* [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 25; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 33; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 34; Vendimi për Paraburgimin, f. 18, rreshti 16-20; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 54.

akuzuari të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së ose të kryejë vepra penale të tjera.³³ Në veçanti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se asnjë kusht i mundshëm i përcaktuar: (i) nuk trajton, për shembull, mundësinë që z. Thaçi të shfrytëzojë të tjerë ose të përdorë pajisje për komunikim të personave të tjerë ose t'u kërkojë personave të tjerëve të përdorin pajisjet e tyre për të ndërhyrë paligjshëm ndaj dëshmitarëve; dhe (ii) nuk mund të sigurojë monitorim efektiv të komunikimeve të z. Thaçi. Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh gjithashtu se, përkundër kushteve (në qoftë se lirohet), i akuzuari do të jetë në gjendje, do të ketë motiv dhe mundësi të këmbëngulë në vazhdimin e përpjekjeve për pengim të procesit të DHS-së.³⁴

26. Gjithashtu, sipas mendimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake, megjithëse rreziku i mesazheve dhe udhëzimeve të paligjshme nuk mund të eliminohet plotësisht, masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të marra në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundër vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarë të familjes dhe vizitorë të miratuar paraprakisht, me synimin për të zvogëluar sa më shumë rrezikun e pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera.³⁵ Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se Administratorja dhe paneli, që kanë qasje të pakufizuar në informacionin

³³ [Thrid Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 28. [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 37; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 38; *shih* KSC-BC-2020-06, IA017/F00011/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit), 5 prill 2022, publik, para. 51.

³⁴ [Thrid Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 28; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 37; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 38.

³⁵ [Thrid Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 29. [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 38; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 39; *Shih ngjashëm* KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit), 27 tetor 2021, publik, para. 68.

konfidencial lidhur me dëshmitarët dhe viktimat, mund të ndërmarrin veprime më shpejt se autoritetet e tjera që veprojnë sipas një kornize të ndryshme.³⁶

27. Rrjedhimisht, bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se çfarëdo kushti i arsyeshëm që mund të vendoset nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, mbetet i pamjaftueshëm për të zvogëluar në masën e duhur rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

28. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Thaçi gjendet në paraburgim që nga 5 dhjetori 2024 në kontekst të këtij procesi;³⁷ (ii) kundër tij janë ngritur tri (3) akuza për tentim të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, katër (4) akuza për shkelje të fshehtësisë së procesit dhe katër (4) akuza për mosbindje ndaj gjykatës, për të cilat ai mund të dënohet përkatësisht ne deri në pesë (5) vjet, tri (3) vjet dhe gjashtë (6) muaj; dhe (iii) rreziqet e parapara në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) të Ligjit nuk mund të zvogëlohen me asnjë prej kushteve të propozuara për lirim.³⁸

29. Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh gjithashtu se, që nga Vendimi i Tretë i Rishikimit: ZPS-ja ka përfunduar (në pjesë të madhe) nxjerrjen e provave që ka në zotërim sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores³⁹ dhe ka nxjerrë

³⁶ [Thrid Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 29. [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 38; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 39; *Shih ngjashëm* KSC-BC-2023-10, F00165, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Haxhi Shala](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Haxhi Shalës kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit), 9 shkurt 2024, publik, para. 54.

³⁷ *Shih më lart*, para. 1.

³⁸ *Shih më lart*, para. 27.

³⁹ *Shih* Paketat 50, 54 dhe 55 të materialit të nxjerrë. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2023-12, F00100, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters](#) (Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me To), 20 dhjetor 2024, publik, para. 45, 104(c), (e) (ku 17 marsi 2025 caktohet si datë për nxjerrjen e këtij materiali); F00256, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Authorizing Additional Disclosure under Rule 102\(1\)\(b\) of the Rules](#) (Vendim për Autorizimin e Nxjerrjes së Mëtejshme të Materialit sipas Rregullës 102(1)(b) të Rregullores), 11 prill 2025, publik. Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka caktuar gjithashtu afatin përkatës për nxjerrjen e disa materialeve sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores dy (2) muaj nga data e transferimit të materialit në fjalë ZPS-së, gjë që u krye më 17 korrik 2025 (*shih* KSC-BC-2023-12,

material tjetër sipas rregullës 103 të Rregullores;⁴⁰ (ii) ZPS-ja ka dorëzuar njoftimin e saj të tretë sipas rregullës 102(3) të Rregullores⁴¹ dhe ka nxjerrë një numër materialesh, siç kërkoi Mbrojtja;⁴² (iii) kryerja e hapave hetimorë të papërfunduar vijon me ritëm të rregullt,⁴³ dhe materiali shtesë parashikohet të nxirret pas përfundimit të këtyre hapave⁴⁴ (iv) janë lëshuar vendimet në lidhje me të gjitha mocionet paraprake të dorëzuara nga Mbrojtja dhe pritet të lëshohen vendimet e apelit në lidhje me to;⁴⁵ si dhe si rezultat i apeleve të miratuara nëpërmjet lejes nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake;⁴⁶ dhe (v) Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka

F00368, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Qasje në Material dhe Çështje Përkatëse* ("Vendimi për Qasje në Material"), 9 korrik 2025, konfidencial, para. 53, 57(i), me Shtojcën 1, konfidenciale; F00377, Zyra Administrative, *Njoftim i Transferimit të Materialeve sipas Vendimit F00368* ("Njoftimi i Transferimit"), 17 korrik 2025, konfidencial.

⁴⁰ Shih Paketat 46, 48 të materialit të nxjerrë .

⁴¹ Shih KSC-BC-2023-12, F00341, Prokurorja e Specializuar, *Njoftimi i Tretë i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3) të Rregullores*, 17 qershor 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁴² Shih Paketat 47, 49, 51, 52, 53, 56 dhe 57 të materialit të nxjerrë.

⁴³ Shih KSC-BC-2023-12, F00342, Regjistrar, *Raport i Zyrës Administrative sipas Urdhrit F00221*, 19 qershor 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-6, konfidenciale; F00346, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Subjektin e Pavarur për të Ekzaminuar Materialin e Ruajtur*, 24 qershor 2025, konfidencial; F00350, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Pajisjet Elektronike të Pakontrolluara të Kuçit dhe Kërkesën Përkatëse për Ndihmë*, 26 qershor 2025, konfidencial; F00357, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Caktimin e Mbrojtës së Pavarur dhe Nisjes së Fazës 2 të Mekanizmit për Ekzaminim të Materialit të Ruajtur*, 1 korrik 2025, konfidencial; F00360, Administratorja, *Njoftim i Caktimit të Mbrojtës së Pavarur*, 2 korrik 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale; Vendimi për Qasje në Material; Njoftimi i Transferimit; F00386, Administratorja, *Raport i Administratores në lidhje me Kryerjen e Ekzaminimit nga Mbrojtësja e Pavarur për Fazën 2*, 21 korrik 2025, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00399, Administratorja, *Raport i Administratores në lidhje me Transferimin e Materialeve sipas Vendimit F00368*, 30 korrik 2025, konfidencial.

⁴⁴ Shih Vendimin për Qasje në Material, para. 53, 57(i).

⁴⁵ KSC-BC-2020-06, F00347, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on the Thaçi Defence Preliminary Motion on Jurisdiction](#) (Vendim mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit mbi Juridiksionin), 19 qershor 2025, publik; F00347, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Preliminary Motions Alleging Defects in the Indictment](#) (Vendim mbi Mocionet Paraprake që Pretendojnë Mangësi në Aktakuzë), 24 June 2025, public; F00354, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocione Paraprake për Shtyrje të Procesit dhe Veçimin e Çështjeve Gjyqësore*, 30 qershor 2025, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më 1 korrik 2025, [F00354/RED](#). Shih gjithashtu IA005/F00001, Mbrojtja e Thaçit, *Apel Kundër Vendimi mbi Mocionin Paraprak të Thaçit lidhur mbi Juridiksionin*, 2 korrik 2025, konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, publike. Versioni i redaktuar publik i parashtrimit kryesor dhe versioni i korrigjuar i tij u lëshuan më përkatësisht më 4 korrik 2025 dhe 7 korrik 2025, IA005/F00001/RED dhe IA005/F00001/RED/COR.

⁴⁶ KSC-BC-2023-12, F00390, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake për Shtyrje të Procesit dhe Veçimin e Çështjeve Gjyqësore*, 23 korrik 2025, konfidencial, versioni i redaktuar publik u lëshua të njëjtën ditë, [F00390/RED](#); F00391, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on the Thaçi Defence Request for](#)

caktuar afatin për dorëzimin e Dosjes Paraprake të ZPS-së dhe hapat më pas.⁴⁷ Rrjedhimisht, procesi vijon me ritëm të shpejtë, çka bën që çështja të jetë një hap më afër kalimit të saj trupit gjykues.

30. Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka vlerësuar në mënyrë të duhur kohën shitesë që z. Thaçi ka kaluar në paraburgim që nga Vendimi i Tretë i Rishikimit, por gjykon se – kur krahasohet me faktorë të tjerë të përshkruar në paragrafët 28-29 më lart – paraburgimi i tij mbetet proporcional.

31. Gjithashtu, sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Thaçi do të rishikohet në mënyrë të rregullt pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin ose në çdo kohë, në bazë të një kërkesë apo *proprio motu*, kur ka ndryshime të rrethanave që nga rishikimi i fundit.

32. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se z. Thaçi nuk është mbajtur në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores.

V. VENDIM

33. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit e z. Thaçi;
- b. **URDHËRON** z. Thaçi që, nëse dëshiron, të dorëzojë parashtime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri të **premtën, 29**

[*Certification to Appeal the "Decision on the Thaçi Defence Preliminary Motion on Jurisdiction"*](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit mbi Juridiksionin), 23 korrik 2025, publik; F00392, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [*Decision on the Thaçi and Fazliu Requests for Certification to Appeal the "Decision on Preliminary Motions Alleging Defects in the Indictment"*](#) (Vendim mbi Kërkesat e Thaçit dhe të Fazliut për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake që Pretendojnë Mangësi në Aktakuzë), 24 korrik 2025, publik.

KSC-BC-2023-12, F00395, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Urdhër në lidhje me Kalendarin për Procedurat Paraprake të Mbetura*, 25 korrik 2025, publik.

gusht 2025, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores; dhe

- c. **URDHËRON** ZPS-në që, në qoftë se z. Thaçi vendos të mos dorëzojë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të dorëzojë parashtrime për rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Thaçi jo më vonë se **të hënë, 5 shtator 2025, në orën 16:00** dhe që z. Thaçi, nëse dëshiron, të dorëzojë përgjigje jo më vonë se **të hënë, 15 shtator 2025, në orën 16:00**.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E martë, 5 gusht 2025

Në Hagë, Holandë.